



**Informimi javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°25/2022

Hagë, 30/06/2022

Përditësim

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'ju ofrojmë gazetarëve një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të drejtuar pyetje.

Më 21 qershor, Kryetarja e Dhomave të Specializuara caktoi panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur lidhur me apelet e dorëzuara nga Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj kundër Aktgjykimit të 18 majit. Paneli përbëhet nga gjykatësit Mishelë Pikar, Kai Ambos dhe Nina Jorgensen.

Më 22 qershor, Kryegjykatësja Mishelë Pikar caktoi datën për një konferencë para apelit e cila do të zhvillohet javën e ardhshme, më 5 korrik, në orën 14:00. Gjatë konferencës para apelit, personit të paraburgosur që është në pritje të apelit i jepet mundësia të ngrejë, në seancë publike, çështje lidhur me paraburgimin, përfshirë edhe lidhur me gjendjen mendore dhe fizike të personit.

Më 22 qershor, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Pjetër Shala, pasi konstatoi se ekzistonte ende rreziku i arratisjes, pengimit të procesit apo kryerjes së krimeve të tjera. Gjykatësi i Procedurës Paraprake më tej konstatoi se komunikimet e z. Shala mund të kufizohen në një mënyrë që i zvogëlon mjaftueshëm këto rreziqe vetëm me anë të zbatimit të kornizës për monitorimin e komunikimeve që përdoret në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Ndër lajme të tjera: aktiviteti i Programit për Komunikim dhe Ndërgjegjësim me Kryetaren e DHSK-së, që fillimisht ishte planifikuar të mbahej në Gjilan më 4 korrik, tani do të zhvillohet tërësisht në internet pasi shumica e pjesëmarrësve shprehën parapëlqimin të merrnin pjesë në këtë takim përmes platformës Zoom. Kryetarja e shtyu vizitën e saj në Kosovë për pas periudhës së verës.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

1

